

VENDIM
Nr.481, datë 14.6.2006

**PËR LEJIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË RRUGËVE TË PËRDORË
PROCEDURËN E PROKURIMIT “TENDER I HAPUR NDËRKOMBËTAR, PËR
NDËRTIMIN, ME RITME TË PËRSHPEJTUARA”, TË SEGMENTIT RRUGOR
RRËSHEN-KALIMASH, TË AUTOSTRADËS DURRËS-KUKËS-MORINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, që të përdorë procedurën e prokurimit “Tender i hapur ndërkombëtar, për ndërtimin me ritme të përshpejtuar” të segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash, të autostradës Durrës-Kukës-Morinë, si më poshtë vijon:

a) Publikimin e kërkesës për shprehje interesi, në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet njoftimit në “Gazetën Zyrtare” të Komisionit European dhe gazetën “Financial Times”.

b) Kandidatët e interesuar të dorëzojnë shprehjen e interesit, jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i kërkesës për shprehje interesi.

c) Kandidatët e interesuar të klasifikohen sipas nivelit të kualifikimit për karakteristikat e projektit. Ky klasifikim të bëhet nga një komision ndërkombëtar vlerësimi, i pavarur, i përbërë nga pesë anëtarë, të caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në bazë të propozimeve të konsulentit ndërkombëtar “Ecorys Group”, që asiston në përgatitjen e procedurave të prokurimit.

ç) Klasifikimi të bëhet sipas kriterëve të mëposhtme:

i) Situata financiare; xhiro vjetore në punime civile prej të paktën një miliard dollarësh amerikanë dhe shoqëria, si e tërë, të ketë rezultuar me fitim për tre vitet e fundit (kriter kalues/skualifikues);

ii) Përvoja në rajon (masë vlerësimi 10 për qind);

iii) Përvoja me tunelet (masë vlerësimi 10 për qind);

iv) Përvoja në menaxhimin e procesit të hartimit të projektit teknik dhe vlerës inxhinierike (masë vlerësimi 15 për qind);

v) Përvoja në sigurimin e financimit, garancive dhe kredive të eksportit (masë vlerësimi 15 për qind);

vi) Përvoja e drejtuesit të punimeve (masë vlerësimi 10 për qind);

vii) Përvoja me kontrata me çmime njësi (masë vlerësimi 5 për qind);

viii) Përvoja në realizim projektesh, në kohë dhe brenda buxhetit (masë vlerësimi 20 për qind);

ix) Propozimi për të siguruar çmim të arsyeshëm dhe realizimin në kohë (masë vlerësimi 15 për qind).

d) Komisioni i vlerësimit t’i klasifikojë ofertuesit me një notë nga 1 deri në 10, për çdo kriter, ku një notë mund të përdoret vetëm një herë për secilin kriter të përcaktuar, shumëzuar kjo me përqindjen e masës së vlerësimit dhe mbledhur për nëntë kriteret.

dh) Kandidati i klasifikuar me më shumë pikë të ftohet për negociatë, me qëllim arritjen e një marrëveshjeje të ndërsjellë për metodologjinë e çmimit dhe planin e punimeve. Çmimet për njësi mund të jenë objekt i verifikimit të pavarur prej një pale të tretë, në varësi të negociatave.

e) Pas përfundimit me sukses të negociatave me kandidatin e klasifikuar me më shumë pikë, të bëhet njoftimi për procedim.

ë) Në rast të negociatave të pasuksesshme me kandidatin e klasifikuar i pari, me më

shumë pikë, të ftohet për negociim kandidati i klasifikuar i dyti.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha